



Ministria e Shëndetësisë Org. Jeshmë Org. Umr. 01		Nr. Prot. Umr. Prot. 05-5005	
Nr. faqeve Br. stranica -5-		Data: Datum 03.07.2025	
No. pages		Pristinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health
Zyra e Ministrit- Ured Ministra -Office of the Minister

Nr: 98/VII/2025

Datë: 03/07/2025

Zëvendësministri i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në përputhje me nenet 11 dhe 16 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7, 01 Mars 2019), nenit 12 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive Shtojca 1 paragrafi 6 nëparagrafi 6.1, në zbatim të Ligjit nr. 02/L-78 Ligji për shëndetësi publike dhe në bazë të rekomandimeve të IKSHPK-së, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Për Informata dhe rekomandime mbi masat mbrojtëse ndaj ekspozimeve në temperaturat e larta

1.Ministria e shëndetësisë Rekomandon masat mbrojtëse ndaj ekspozimeve në temperaturat e larta për institucionet publike, si në vijim:

- 1.1 Të përshtatin oraret e punës për të punësuarit e tyre dhe sipas mundësive të aplikohet orar fleksibël të punës që nënkupton lejimin e punëtorëve që të fillojnë punën më herët në mëngjes ose të punojnë nga shtëpia nëse ka mundësi;
- 1.2 Shtatzënat të lirohen nga puna gjatë orëve të pikut të nxehtësisë, ose të punojnë nga shtëpia;
- 1.3 Personat më sëmundje kronike dhe me gjendje shëndetësore të rënduar, të lejohen të punojnë nga shtëpia;
- 1.4 Të sigurohet ajrosja e mjaftueshme në vendet e punës të mbyllura;
- 1.5 Të vendosen pika freskimi (përdorim i çadrave të lëvizshme dhe materialeve të tjera për të krijuar hije apo zona freskimi) në vend-punishtet e hapura për freskim të punëtorëve dhe të sigurohet qasje në ujë të ftohtë për punëtorët;
- 1.6 Të shpërndahen informacione përmes burimeve të informimit për qytetarët për mënyrat e mbrojtjes nga nxehtësia;

1.7 Ata që merren me punët në bujqësi, të planifikojnë zhvillimin e punëve të tyre në mëngjes herët ose pasdite vonë për të shmangur ekspozimin në nxehtësinë e madhe.

1.8 Institucionet private po ashtu këshillohen që të marrin në konsideratë këto rekomandime nga IKSHPK

2. Me qëllim që institucionet dhe subjektet e ndryshme ta kenë më të lehtë zbatimin e vendimit për kategorinë e qytetarëve me sëmundje kronike, bashkëlidhur është Lista e sëmundjeve kronike, 2024, të cilat mund të konsiderohen me rastin e zbatimit të vendimit.

3. Mbi kohën e lejuar për punë në ambiente të jashtme në temperatura të larta rekomandohet që të zbatohet Rregullorja MPMS Nr.01/2020 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, faqe 41 dhe 42, në këtë vegëz <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=32300> ;

4. Për më tepër informata për mbrojtjen e të punësuarve gjatë temperatura të larta, rekomandohet të zbatohet dokumenti “Nxehtësia në punë – Udhëzues për vendet e punës”; i vendosur në këtë vegëz <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/b46f1215-2a3c-43b9-8153-19e8ad6fdec0.pdf>;

5. Ministria e Shëndetësisë rekomandon masat mbrojtëse ndaj ekspozimeve në temperaturat e larta për qytetarët, si në vijim:

5.1. Të shmangët qëndrimi në ambientin e jashtëm në pikun e nxehtësisë;

5.2 Të konsumohet ujë për tu mbrojtur nga dehidrimi dhe të shmangen pijet e gazuara;

5.3 Të përdoren kapelë dhe syze mbrojtëse nga dielli kur qëndrohet jashtë;

5.4 Mos të lihen fëmijët vetëm në veturë deri sa prindërit/kujdestarët kryejnë ndonjë punë;

5.5 Të kontaktohen rregullisht të afërmit e moshuar ose me sëmundje kronike për të konfirmuar nevojat shëndetësore të tyre;

6. Vendimi hyn në fuqi fillon të zbatohet prej 3 deri në 10 korrik 2025;

Dr. Arsim Berisha

Zëvendësminister i Shëndetësisë

Vendim i dërgohet:

- Zyrës së Kryeministrit;



- Sekretarit të Përgjithshëm;
- IKSHPK;
- SHSKUK;
- AKKPM
- Të gjitha Institucionet e kujdesit parësor shëndetësor;
- QKTGJK;
- Fssh;
- Inspektoratit qendror shëndetësor;
- Departamentit të burgjeve;
- Departamentit ligjor;
- Divizionin për komunikim Msh;
- Divizionit të burimeve njerëzore Msh;
- Arkivit të MSh-së.

Lista e sëmundjeve kronike

- Tumoret/Kanceret
- Sëmundjet kardiovaskulare, duke përfshirë sëmundjet cerebrovaskulare, dështimin e zemrës dhe kardiopatinë ishemike
- Sëmundjet kronike të frymëmarrjes, si astma dhe sëmundja kronike obstruktive pulmonare (COPD)
- Diabeti mellitus (tipi 1, tipi 2, paradiabeti, diabeti gestacional)
- Sëmundja e Alzheimerit
- Fibrilacioni atrial
- Çrregullimi i hiperaktivitetit të deficitit të vëmendjes
- Sëmundjet autoimune, të tilla si koliti ulceroz, lupus eritematoz, sëmundja e Crohn, sëmundja celiace, tiroiditi Hashimoto dhe polikondriti i përsëritur
- Verbëria
- Paraliza cerebrale (të gjitha llojet)
- Sëmundja kronike e transplantit kundër strehuesit
- Hepatiti kronik
- Pankreatiti kronik
- Sëmundja kronike e veshkave si Insuficiencia renale kronike
- Sëmundjet kronike osteoartikulare, të tilla si osteoartriti dhe artriti reumatoid
- Sindromat e dhimbjes kronike, të tilla si sindroma e dhimbjes pas vazektomisë dhe sindroma komplekse e dhimbjes rajonale
- Shurdhimi dhe dëmtimi i dëgjimit
- Endometrioza
- Epilepsia
- Fibromialgjia
- Sferocitoza e trashëguar
- Sëmundja e Huntingtonit
- Hipertensioni
- Dislipidemia (kolesteroli i lartë)
- Sëmundjet mendore
- Migrena
- Skleroza e shumëfishtë
- Encefalomieli mialgjik (sindroma e lodhjes kronike)
- Narkolepsia

• Obeziteti
• Osteoporoza
• Sëmundja e Parkinsonit
• Sëmundja periodontale
• Sindroma e vezores policistike
• Sindroma e takikardisë ortostatike posturale
• Anemia drapërocitare dhe çrregullime të tjera të hemoglobinës
• Çrregullimet e abuzimit me substancat
• Apnea e gjumit
• Sëmundja e tiroides
• Artriti
• Ekzema
• Alergjitë në nivele të larta të ndotjes dhe në mjediset e brendshme me kondicionim jo-adekuat të ajrit, pluhur e myk
• Hepatiti C

Shpjegim: Lista e sëmundjeve kronike i përfshin ato sëmundje që zgjasin për një periudhë të gjatë kohore, zakonisht për më shumë se tre muaj, dhe shpesh kërkojnë menaxhim të vazhdueshëm mjekësor. Kjo listë nuk pretendon të ketë përfshirë të gjitha, por ato që janë më karakteristike dhe më të pranishme në popullatë